




Alberte Poshku

Aurela Saliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2718 / Prot. 14

Vlorë më, 11.11.2024

**VENDIM**

Nr. 84, datë 20.11.2024

**PËR  
MIRATIMIN RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER I  
SHKENCAVE NË MËSUESI GJUHË E HUAJ GJUHË ANGLEZE"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit Nr.1, datë, 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe referuar relaconit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën nr.2463/5 prot, datë 05.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 20.11.2024,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren e programit të studimit "Master i Shkencave në mësuesi gjuhë e huaj gjuhë angleze" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit Akademik, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhëve të Huaja në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Aurela Saliaj**

